



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +381-38-244-183 • www.uni-pr.edu

Ref. nr. 1151

Prishtinë, Dt. 08/04/2025

RAPORT I VLERËSIMIT TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TE DIPLOMES
MASTER

FAKULTETI	I Shkencave Matematike Natyrore
Departamenti/ Programi	Master i Gjeografisë
Projektpropozimi	"Potenciali i prodhimit të energjisë solare në shkollat fillore të Prishtinës, bazuar në gjeoinformacione"
Kandidati	Rina Marion RAMA
Mentori	Prof.Dr.Florim Isufi
Aprovimi i projekt propozimit në	Datë:29.02.2024
Këshillin e Fakultetit	Vendimi nr.:716

ANALIZA E DORËSHKRIMIT

Një mënyrë për të kufizuar faktorët që ndikojnë në mjedis është menaxhimi i energjisë, i cili, është shuma e masave që përfshijnë të gjitha aktivitetet e dizajnuara për të garantuar përdorimin efikas të burimeve të disponueshme të energjisë. Këto aktivitete përfshijnë kursimin e energjisë, përdorimin racional të energjisë dhe zëvendësimin e burimeve të energjisë me të tjera. Kandidati ka pas për qëllim kalkulimin e potencialit të prodhimit të energjisë solare në shkollat fillore të qytetit të Prishtinës. Pjesë e hulumtimit kanë qenë 19 shkolla, nga gjithsej 43 që përfshinë komuna e Prishtinës. Kalkulimet ka treguar që një pjesë e madhe e këtyre shkollave, kanë potencial të lartë të prodhimit të energjisë solare, kjo tregon që gjasat që këto shkolla të shndërrohen në Zero Energy Buildings, janë të larta.

Kandidati duke analizuar potencialin e prodhimit të energjisë solare për shkollat e Kryeqytetit, ka konstatuar disa pika kyçe dhe faktorë që ndikojnë në prodhimin vjetor të energjisë:

- 1, Faktori i sipërfaqes së panelit solar m^2 ,
2. Faktori i rrezatimit diellor,

3. Faktori i pozitës gjeografike.

4. Lidhja ndërmjet sipërfaqes dhe prodhimit:

Pas analizave dhe përfitimit të rezultateve kandidati ka llogaritur edhe koeficientin e korrelacionit për përputhjen e sipërfaqes së tërësishme dhe sipërfaqes së përshtatshme për panele solare në kulmet e shkollave të Prishtinës.

Koeficienti i Korrelacionit të Pearsonit mat forcën dhe drejtimin e lidhjes lineare midis dy variablave. Rezultati i llogaritur prej 0.5469 tregon një lidhje pozitive mesatare deri të fortë midis Sipërfaqes së përgjithshme të kulmit dhe Sipërfaqes së panelit solar. Kjo nënkupton që, me rritjen e njërës madhësi, edhe tjetra ka tendencë të rritet, megjithëse lidhja nuk është plotësisht e përsosur. Nga analiza e bërë, është konstatuar se e gjithë sipërfaqja e kulmeve të shkollave, nuk është plotësisht në përputhje me mundësinë e shfrytëzimit të paneleve solare dhe se ekspozicioni i pjesëve të caktuara të kulmeve nuk është në tërësi i mjaftueshëm për vendosjen dhe shfrytëzimin e paneleve solare. Ky rezultat, i kombinuar me analizën e mëparshme mbi potencialin e prodhimit të energjisë solare, sugjeron se disa nga shkollat e përfshira në studim, me disa investime shtesë, kanë një mundësi të lartë për t'u shndërruar në ndërtesa me konsum zero të energjisë (Zero Energy Buildings). Gjithashtu, bazuar në këtë studim është konstatuar që iniciativat për ndërtimin e objekteve të reja shkollore në Prishtinë, të marrin parasysh ekspozicionin e kulmeve që të jenë të përshtatshme për vendosjen e paneleve solare, duke pas parasysh se energjia elektrike e fituar nga rrezatimi diellorë do të jetë parësor në shfrytëzimin e energjisë nga shkollat.

Në fund të punimit kandidati jep disa rekomandime të cilat do të përmirësonin gjendjen e dhe mundësin e fitimit të energjisë elektrike solare për nevojat e shkollave të Prishtinës.

Prishtinë, 28.03.2025

Komisioni:

1.

/ Prof. Asoc. Dr. Shpejtim Bulliqi, – kryetar/

2.

/ Prof. Dr. Florim Isufi – anëtar (mentor)

3.

/ Prof. Ass. Dr. Fitim Humolli – anëtar/

P.S. Numri i faqeve shtohet sipas nevojës.